

MENAXHMENT - VITI I DYTË- SEMESTRI I

Bazat e Menaxhmentit (O): 7 ECTS

Qëllimi i kësaj lënde është, që studentët të përfitojnë njohuritë e nevojshme nga bazat e menaxhimit, përkatësisht menaxhmentit si aktivitet, i cili realizohet me ndihmën e funksioneve themelore, në arritjen e qëllimeve të organizatës, kuptimin e parimeve themelore mbi të cilat zhvillohet dhe funksionon menaxhimi, kuptimi i ndërveprimit të menaxhimit me veprimtaritë tjera, mënyrën bashkëkohore të menaxhimit, aplikimi i njohurive themelore për analizën, planifikimin, organizimin, menaxhimin dhe kontrollin e zhvillimit në praktikë, zgjidhjen e problemeve konkrete në ekonomi dhe biznes.

Bazat e Marketingut (O): 6 ECTS

Qëllimi i kësaj lënde është, që studentët të pajisën me njohuritë për marketingun. Përcaktimi i bazave të marketingut dhe shpjegimeve të tendencave teorike dhe metodike, pse ekziston një sistem marketingu. Përshkrimi i organizimit të marketingut në përgjithësi, instrumentet kryesore dhe natyrën e marketingut në përgjithësi. Aftësimin e studentëve në shpjegimin e fenomeneve të tilla, si: shtimin e vlerës së produkteve në lidhje me kohën, formën, vendin, dhe lehtësirat për zotërim. Aftësimin e studentëve në vlerësimin e faktorëve kyç, që veprojnë në organizimin dhe performancën e sistemit të marketingut dhe të kuptimit sa më në thellësi, të historisë së zhvillimit të vetë këtij lloji marketingu, etj.

Makroekonomi II (O): 6 ECTS

Qëllimi i kësaj lënde është, që studentët të zgjerojnë njohuritë e tyre në fushën e makroekonomisë, mbi rritjet dhe rëniet ciklike të prodhimit, produktin total të të mirave dhe shërbimeve dhe rritjen e tij, normat e inflacionit dhe të papunësisë, bilancin e pagesave dhe kurset e këmbimit, si dhe modelet me anë të të cilave mund të bëjnë analiza më detale në këtë lëmi.

Menaxhimi i Burimeve Njerëzore (O): 6 ECTS

Qëllimi i kësaj lënde është, që t`ju mundësojë studentëve që ta njohin ndikimin e rrethinës në menaxhimin e resurseve njerëzore, do të ofrojë mundësi që nëpërmjet këtij programi, të studiohet metodologjia e zhvillimit të resurseve njerëzore, të mësojnë që njohurinë e fituara t`i zbatojnë në ndërmarrje, institucione, etj. Do të trajtohen aspekte praktike të menaxhimit të resurseve njerëzore, menaxhimi strategjik i resurseve njerëzore.

Ekonomiksi i Tregut të Punës (Z): 5 ECTS

Qëllimi i kësaj lënde është, që studentët të përdorin teorinë ekonomike, për të analizuar ofertën dhe kërkesën për punë, ekuilibrin në tregun e punës dhe vendosjen e pagës në treg, investimi në kapitalin njerëzor dhe kthimi nga ky investim, efektet në tregun e punës (punësim/papunësi) të politikave të caktuara të tregut të punës etj.

Ekonomiksi i Sektorit Publik [Z]: 5 ECTS

Qëllimi i kësaj lënde është që studentë të njohohen me njohuritë e sektorit publik, të njohohen me rolin e shtetit dhe institucioneve shtetërore në sektorin publik, ti shohin se cilat janë mënyrat që shteti ndikon në fushën e ekonomisë, në cilat sektorë ekonomike duhet që shteti të jetë i pranishëm, se si ndikon në rritje sektori publik përmes tregut të punës etj.

Paraja dhe Financa [Z]: 5 ECTS

Qëllimi i kësaj lënde është që studentët të fitojnë njohuritë e duhura për parën, financat, tregun dhe institucionet financiare në përgjithësi, të aftësohen në funksionet e parasë dhe financave në raport me konsumatorin, teoritë e kërkesave për para, inflamacionin dhe sistemin financiar, të njohohen me tregun e parasë, unitetin e institucioneve të parasë dhe institucioneve financiare.

Kontabiliteti Financiar [Z]: 5 ECTS

Qëllimi i kësaj lënde është që studentët të pajisen me dituri bazike dhe të thelluara me fushën e kontabilitetit financiar, të aftësohen në detyrimet afatshkurta dhe afatgjate, do të njohohen me efektin e ortakërive, financimin e korporatave përmes ekuitetit dhe përmes borxhit, do të aftësohen në pasqyrat e cash-flowit, duke e analizuar pasqyrat financiare përmes treguesve financiar. Gjithashtu do të shohin obligacionet e pagueshme, pasqyrat e rrjedhjes së parasë, të mësohen në krijimin PF individuale, në trajtimin kontabël të tatimeve dhe taksave etj.

MENAXHMENT - VITI I DYTË- SEMESTRI II

Ndërmarrësia (O): 7 ECTS

Qëllimi i kësaj lënde është që studentët përfitojnë njohuri të nevojshme zhvillimit të shkencës dhe koncepteve të ndërmarrësisë, zhvillimi i ideve ndërmarrëse, të kuptuarit dhe definimin e ndërvarësisë, analizimi i mjedisit për mundësitë ndërmarrëse, hartimi i planeve të biznesit, formimi i aftësive dhe shkathtësive për te planifikuar, gjeneruar dhe menaxhuar bizneset, zhvillimi i biznesit të vogël dhe të mesëm në Kosovë, biznesi ndërkombëtar etj. Të përfitojnë njohuritë e nevojshme nga: konceptet themelore të ndërmarrësisë, zhvillimin i ideve ndërmarrëse, analizimin e mjedisit për mundësitë ndërmarrëse, të hartoj dhe zbatoj planet e biznesit, të filloj dhe menaxhoj një biznes, mundësitë e biznesit ndërkombëtar, mundësitë e zhvillimit të biznesit të vogël dhe të mesëm në Kosovë

Makroekonomi II (O): 6 ECTS

Qëllimi i kësaj lënde është që studentët të zgjerojnë njohuritë e studentëve në fushën e makroekonomisë, mbi rritjet dhe rëniet ciklike të prodhimit, produktin total të të mirave dhe shërbimeve dhe rritjen e tij, normat e inflacionit dhe të papunësisë, bilancin e pagesave dhe kurset e këmbimit, si dhe modelet me anë të të cilave mund të bëjnë analiza më detale në këtë lëmi.

Menaxhimi i Riskut (O): 6 ECTS

Qëllimi i kësaj lënde është që studentëve shpjegohet për paraqitjen, identifikimin, matjen, mënyrat e menaxhimit të riskut në ndërmarrje, korporata, menaxhimin e riskut financiar, operativ, të interesit, të kredisë, si dhe politikat strategjike për të zbutur riskun. Gjithashtu kursi ofron njohuri mbi: Sigurimin e riskut, sigurimet jetësore, shëndetësore, të pronës dhe shpërndarjen e riskut dhe përgjegjësi.

Menaxhimi i NMV-ve (O): 6 ECTS

Qëllimi i kësaj lënde është që studentët pas përfundimit të kursit, studenti do të jetë në gjendje të: Identifikojnë definicionet alternative të ndërmarrësit, ndërmarrësisë dhe bizneseve të vogla dhe të mesme (BVM). Vlerësojnë rolin e ndërmarrësisë dhe BVM në ekonominë kombëtare dhe ndërkombëtare. Sqarojnë se si firmat krijohen, zhvillohen dhe rriten dhe se si roli i ndërmarrësit ndryshon në këtë proces. Diferencojnë në mes të fushave të ndryshme të menaxhimit që në fazën e themelimit e deri të rritja e biznesit. Identifikojnë barrierat me të cilat përballen ndërmarrësit dhe mënyrat për tejkalimin e tyre.

Menaxhimi i Cilësisë (Z): 5 ECTS

Qëllimi i kësaj lënde është që studentët do të analizojnë konceptet e cilësisë, rëndësinë e saj, principet dhe parimet e menaxhimit të cilësisë, teknikat dhe metodat bashkëkohore që aplikohen më shume sot në fushën e planifikimit, kontrollit, zhvillimit dhe analizës së cilësisë. Pas studimit të kësaj lënde studentët do të: Formojnë pikëpamjet bazë për Menaxhimin e cilësisë; Kuptojnë: konceptin e kërkesës së konsumatorëve për produkte dhe shërbime me cilësi; nevojën e analizës së konkurrencës në menaxhim të cilësisë; rëndësinë e aplikimit të teknikave dhe metodave për menaxhimin e cilësisë; rëndësinë e ndërtimit të strukturave të afta për menaxhimin e cilësinë.

E-Biznesi [Z]: 5 ECTS

Qëllimi i kësaj lënde është studentët të njohohen me konceptet e duhura të disa modeleve bashkëkohore të zhvillimit të biznesit elektronik: B2B, B2C, C2C, C2B. Do të njohohen me konceptet e tregtisë elektronike (E-commerce), e-marketing, e-banking, të njohohen me proceset biznesore të realizuara përmes teknologjisë së informacionit e veçanërisht përmes internetit ose në mënyrë elektronike.

Sjellje Organizative [Z]: 5 ECTS

Qëllimi i kësaj lënde është që studentët të aftësohen në sjelljet organizative, sjelljet ndaj konsumatorëve, të i studiojnë sjelljet dhe mënyrat organizative që një institucion apo kompani të përfitoj në numrin e konsumatorëve, i studiojnë vendimet dhe sjelljet e konsumatorëve para dhe pas blerjeve. Kjo e gjitha është që studentët të nxjerrin informacione të sakta se çka e dërgon të ndryshoj sjellja organizative brenda një institucioni.

Financat e Korporatave [Z]: 5 ECTS

Qëllimi i kësaj lënde është studentët të marrin njohurit e duhura për financat e bizneseve të mëdha – korporatave, bizneseve specifike dhe organizatave si shoqëri aksionare, të aftësohen në menaxhimin e këtyre financave të korporatave, të analizojnë dhe njohin problemet e korporatave në aspektet financiare duke ia mundur që edhe praktikisht zgjidhjen e këtyre problemeve me njohuritë e fituara më herët.